



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Elez Han

01/Nr.8010/2012

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës - Nr. 28/2008) neni 11, 40, Statutin e Komunës neni 79, shkresën përcjellëse me numër 11/Nr.8106 të datës 05.12.2012 nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit me numër 11-Nr.8096/2012. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më 27.12.2012 mori:

VENDIM

PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR KOMPANIN „ARSI” SH.P.K PËR HULUMTIME GJEOLOGJIKE ME SHPIM

I

I jepet në parim pëlqimi kompanisë „Arsi” sh.p.k për shfrytëzimin e parcelave me numër Nr.1362, 1368 dhe 1373 mal i klasit të shtatë, kullos e klasit të shtatë në vendin e quajtur „Rudin” e evidentuar në çertifikatën e pronësisë Nr.137 pronë shoqërore e ekonomisë pyjore zona kadastrale Gorancë me një sipërfaqe prej 268 89 11 ha për hulumtime gjeologjike me shpim për krom dhe bakër.

II

Komuna e Hanit të Elezit në parcelën e lartë shënuar nuk ka plan rregullativ hapësinor, kurse pala për dokumentacionet e tjera të nevojshme duhet të drejtohet në Agjensionin e Pyjeve të Republikës së Kosovës pasi që prona e kërkuar është e ekonomisë pyjore.

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës

IV

Me këtë vendim njoftohet: Kryetari i Komunës, Pala, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit
Data:27.12.2012

Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlashi

